



**MEMORANDUM BASHKËPUNIMI**

**PËR**

**BASHKERENDIMIN E PUNËS PËR SHTIMIN E SHËRBIMEVE PRANË  
DHOMËS SË BIZNESIT TË DIASPORËS**

**NDËRMJET**

**DHOMËS SË BIZNESIT TË DIASPORËS**

**AGJENCISË SHQIPTARE PËR ZHVILLIMINE INVESTIMEVE (AIDA)**

**DHE**

**AGJENCISË SË OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PUBLIKE TË  
INTEGRUARA (ADISA)**



## **PREAMBUL**

Dhoma e Biznesit të Diasporës, e themeluar në kuadër të projektit të Fondit për Zhvillimin e Diasporës të mbështetur nga Këshillit i Ministrave me VKM Nr. 514, datë 19.07.2019,

Agjencia Shqiptare për Zhvillimin e Investimeve (AIDA) krijuar me Ligjin Nr.10 303/2010 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve”,

dhe

Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) krijuar me Ligjin Nr. 13/2016 “Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë”,

të cilët në vijim të këtij dokumenti do të quhen Palë:

*Duke vlerësuar* rëndësinë që ka bashkëpunimi me komunitetet shqiptare në diasporë në ndërtimin e urave lidhëse me vendlindjen;

*Për të nxitur* influencën të cilën ka diaspora në zhvillimin ekonomik dhe rritjen e investimeve në vendin e origjinës;

*Me dëshirën* për të përmirësuar shërbimet me natyrë administrative për anëtarët dhe sipërmarrësit e diasporës shqiptare;

*Duke synuar* mbështetjen e investimeve të diasporës shqiptare me informim të mundësive dhe ofruar shërbime të organizuara;

*Duke afirmuar* vullnetin dhe vendosmërinë për të bashkëpunuar dhe kontribuar në realizimin e këtij memorandum,

Palët bien dakord të lidhin këtë Memorandum Bashkëpunimi, në vijim i quajtur Memorandumi.

### **Neni 1 Qëllimi**

1. Qëllimi i këtij Memorandumi është bashkëpunimi ndërmjet palëve me qëllim shtimin e shërbimeve të ofruara nga Dhoma e Biznesit të Diasporës dhe përmirësimin e cilësisë së tyre nëpërmjet koordinimit me institucionet e specializuara, Agjencia Shqiptare për Zhvillimin e Investimeve (AIDA) dhe Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA).
2. Palët bien dakord që brenda ambjenteve të Dhomës së Biznesit të Diasporës në Tiranë, Agjencisë Shqiptare për Zhvillimin e Investimeve (AIDA) dhe Agjencisë së Ofrimit të



Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) do t'i vendoset në dispozicion hapësira dedikuar për llojin e shërbimeve të cilat ato ofrojnë;

3. Agjencia Shqiptare për Zhvillimin e Investimeve (AIDA) do të kryejë shërbimet në bazë të Ligjit Nr.10 303/2010 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve” ndërsa Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) kryen shërbimet e saj në bazë të ligjit Nr. 13/2016 “Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në RSH”.

## Neni 2

### Objekti i bashkëpunimit

Palët bashkëpunojnë me njëra-tjetrën për përmirësimin e klimës së biznesit, përmirësimin e shërbimit ndaj investitorëve të diasporës nëpërmjet shtimit dhe përqendrimit të shërbimeve publike në selinë e Dhomës së Biznesit të Diasporës duke synuar tërheqjen dhe rritjen e investimeve në vend.

## Neni 3

### Përgjegjësitë e palëve

Bashkëpunimi sipas këtij memorandum realizohet si vijon:

**Dhoma e Biznesit të Diasporës** do të realizojë:

1. Ofrimin pa shpërblim (falas) të bazës materiale, konkretisht: ambientet për vendosjen e posteve të punës; mobilje; pajisje elektronike; pajisje zyre; shërbim telefonik dhe internet si dhe çdo shërbim tjetër të ofruar nga qiradhënësi në bazë të kontratës, duke siguruar kushte normale pune;
2. Zhvillimin e kapaciteteve të nevojshme, me qëllim realizimin e marketingut, nëpërmjet metodave tradicionale e moderne, në bazë të praktikave e përvojës më të mire ndërkombëtare;
3. Ndërmjetësimin, përfaqësimin dhe prezantimin e interesave të të interesuarve dhe sipërmarrjeve të diasporës përpara organeve shtetërore kompetente për realizimin e politikave nxitëse të tërheqjes së investimeve në Republikën e Shqipërisë;
4. Mbledhjen dhe administrimin e kërkesave të investitorëve të diasporës shqiptare për shërbimet e ofruara nga punonjësit e Agjencisë Shqiptare për Zhvillimin e Investimeve (AIDA) dhe Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA).

**Agjencia Shqiptare për Zhvillimin e Investimeve (AIDA) do të realizojë:**

1. Vendosi në dispozicion të një punonjësi brenda hapësirave të zyrave të Dhomës së Biznesit të Diasporës;
2. Ofrimin falas të shërbimit me asistencë dhe konsulencë ndaj investitorëve të diasporës të cilët do t'i drejtohen Dhomës së Biznesit të Diasporës rreth mundësive të investimit në Shqipëri;
3. Organizimin e një bazë të dhënash, ku ruhen dhe përditësohen informacionet për investitorët e diasporës e investimet e tyre, me qëllim ndihmën ndaj tyre;
4. Ofrimin e informacioneve për mundësitë e investimit me qëllim publikimin e tij në faqen zyrtare të Dhomës së Biznesit të Diasporës dhe çdo mundësi tjetër komunikimi në shërbim të investitorëve të Diasporës shqiptare;

**Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) do të realizojë:**

1. Ofrimin e shërbimeve publike për investitorët e diasporës shqiptare (persona fizikë dhe/ose juridikë) nëpërmjet mekanizmit të shërbimit me "një ndalesë";
2. Dhënien e informacionit për procedurat administrative të përfitimit të shërbimit publik;
3. Përditësimin e informacionit të ardhur nga ofruesi i shërbimit, lidhur me procedurat administrative të përfitimit të shërbimeve publike;

#### **Neni 4**

##### **Caktimi i punonjësve**

Punonjësit përgjegjës të cilët do punojnë në hapësirat e Dhomës së Biznesit të Diasporës në realizimin e këtij objektit të këtij Memorandumi, duhet të përmbushin kriteret e kërkuara nga parashikimet ligjore të Agjencisë Shqiptare për Zhvillimin e Investimeve (AIDA) dhe Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA). Ata caktohen nga drejtuesit e këtyre të fundit për të zhvilluar punën e tyre pranë Dhomës së Biznesit për Diasporën.

#### **Neni 5**

##### **Orari i ofrimit të sportelit**

Orari i ofrimit të ambienteve të Dhomës së Biznesit të Diasporës sipas këtij Memorandumi nga punonjësit e Agjencisë Shqiptare për Zhvillimin e Investimeve (AIDA) dhe Agjencisë së Ofrimit

---

të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) është nga e hëna deri të enjten 08:00-16:30 dhe ditën e premte nga ora 08:00-14:00.

## **Neni 6**

### **Komunikimi mes palëve**

1. Palët angazhohen të krijojnë një Sekretari Teknike të përbërë nga përfaqësues të Palëve të cilët do të realizojnë komunikimin dhe koordinimin e veprimeve që duhet të ndërmerren rast pas rasti për realizimin e këtij Memorandumi.
2. Palët, angazhohen të mbajnë një komunikim të vazhdueshëm ndërmjet tyre dhe të shkëmbejnë çdo informacion të nevojshëm për përmbushjen e detyrave të tyre. Komunikimi do të kryhet në formë shkresore ose në rrugë elektronike.

## **Neni 7**

### **Ndryshimi i Memorandumit**

Ky memorandum mund të ndryshoje vetëm me marrëveshje të palëve nëpërmjet shkëmbimit të komunikimit me shkrim.

## **Neni 8**

### **Kohëzgjatja e Memorandumit**

1. Ky memorandum nënshkruhet për një afat kohor prej 4 vitesh.
2. Nëse asnjëra nga palët nuk njofton me shkrim palët për përfundimin e Memorandumit të Bashkëpunimit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë para përfundimit të afatit të përcaktuar sipas pikës 1 të këtij neni, memorandumit ripërtërihet automatikisht.

## **Neni 9**

### **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin ose zbatimin e këtij memorandum zgjidhet me mirëkuptim mes palëve.

---

## **Neni 10**

### **Hyrja ne Fuqi**

Memorandumi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij nga palët dhe publikohet në faqet zyrtare të tyre.

Memorandumi përgatitet dhe nënshkruhet në 6 (gjashtë) kopje origjinale,

Nënshkruar më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2020.

**DHOMA E BIZNESIT TË DIASPORËS**  
**KRYETARI**  
**ARDIAN LEKAJ**

**AGJENCIA SHQIPTARE PËR ZHVILLIMIN E INVESTIMEVE (AIDA)**  
**DREJTORI EKZEKUTIV**  
**SOKOL NANO**

**AGJENCIA E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PUBLIKE TË INTEGRUARA (ADISA)**  
**DREJTORI EKZEKUTIV**  
**LORIN YMERI**